




REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 142 / 15

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 25.06.2015

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 “d” dhe nenin 40.2 “e” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **25 qershor 2015**, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për Verifikimin e gjendjes në rrugën Vushtrri-Prishtinë


1.Me këtë vendim formohet komisioni për verifikimin e gjendjes së trasesë së rrugës Vushtrri-Prishtinë, pas ankesave të fshatrave Lumëmadh dhe Stanoc i Epërm, në këtë përbërje:

- 1.1 Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit (PDK)
- 1.2 Agim Bregaj, anëtar i kuvendit (LDK)
- 1.3 Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit (VV)

2.Komisioni në fjalë duhet të merret me verifikimin e gjendjes faktike të trasesë së rrugës Vushtrri-Prishtinë, dhe pas verifikimit çështjen do ta adresoj në ministrin përkatëse.

3. Për zbatimin e këtij vendim kujdeset komisioni i cekur si në pikën 1 të këtij vendimi.

4.Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhegrova



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 143/15

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 25.06.2015

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 12.1 dhe 40.2 "b" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 40.2 "b" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **25 qershor 2015**, mori këtë:

V E N D I M

Për aprovimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve Buxhetore 2016-2018

1. Aprovohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve Buxhetore 2016-2018 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 01/2016 të lëshuar nga Ministria e Financave, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhegrova